URDHËR
Nr. 110, datë 21.6.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, nga data 24.6.2024 deri më datë 28.6.2024, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Julian Hodaj.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, z. Julian Hodaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla